



Pranimi / Dostizna Prilimi/Delivato Received/Delivaty	19.10.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jednica Organi	Prilimi Pril. No	Shtoja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHICK	6614/2023		118



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.1099/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku Shyti, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1098/2023, të datës 21.08.2023, të parashtruar nga ankuesja dhe ankesës më numër A.nr.1099/2023, të datës 21.08.2023, të parashtruar nga ankuesja dhe ankesës me numër, të bashkuara në ankesën me numër A.nr.1099/2023, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe 1.4; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.10.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1098/2023, e datës 21.08.2023, e parashtruar nga ankuesja Anulohet Njoftimi i datës 21.08.2023, i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Konkurrencës dhe Vendimi Nr.80/23, i datës 21.08.2023, i u.d Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Konkurrencës. Mbetet në fuqi renditja përfundimtare e kandidatëve-Vlerësimi i rezultateve, të datës 31.07.2023.

II. Obligohet Komisioni i Pranimit i themeluar sipas Vendimit Nr.41/23 të datës 24.04.2023, që të shqyrtoj ankesat e kandidatëve dhe të nxjerrë akt administrativ në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

IV. Obligohet u.d Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi siç përcaktohet në pikën II dhe III të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankueset (me tej referuar vetëm ankueset), me datë 21.08.2023, kanë parashtruar ankesë veç e veç në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të plotësuar me datë 23.08.2023 përmes parashtrësës me numër të protokollit 1098/2023 dhe 1099/2023, kundër Vendimit Nr.80/23, të datës 21.08.2023, të u.d Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Konkurrencës, duke pretenduar se vendimi i kundërshtuar me ankesë është jashtë autorizimeve dhe kompetencave të u.d Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës dhe se i njëjti ka ndërhyrë në mënyrë arbitrare duke vendosur jashtëligjshëm. Kërkojnë që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj Vendimin Nr.80/23, të datës 21.08.2023, të u.d Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Konkurrencës dhe të mbesin në fuqi rezultatet përfundimtare.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 24.08.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Autoriteti i Konkurrencës, ndërsa, kjo e fundit, me datë 30.08.2023, ka përcjell shkresat referuar çështjes në shqyrtim dhe vendosje.

Duke qenë se ankesat bazohen në gjendje të njëjtë faktike dhe bazë juridike, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër të protokollit 6528/2023 të datës 12.10.2023, ka bërë bashkimin e ankesave me numër A.nr.1098/2023 të ankueses Elona Sejdullahu dhe ankesës A.nr.1099/2023, të ankueses Arta Fejzullahu, ashtu që ankesat e bashkuara kanë marrë numrin e ankesës A.nr.1099/2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5730/2023 të datës 21.08.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 26.05.2023) të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Autoritetin Kombëtar të Konkurrencës; Njoftimin e datës 11.05.2023 të Njesisë se Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Konkurrencës drejtuar Njoftimin e datës 08.06.2023 nga I. Zarir për Info,Konkurrenca@rks.gov.net; Emalin e datës 13.06.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore drejtuar Emalin e datës 30.06.2023 të Njesisë se Burimeve Njerëzore drejtuar Emalin e datës 31.07.2023 të Njesisë se Burimeve Njerëzore drejtuar Renditja përfundimtare e kandidateve e datës 31.07.2023, Njoftimin e Burimeve Njerëzore të Autoritetin e Konkurrencës (pa datë dhe numër); Emalin e datës 15.08.2023 të drejtuar Emalin e datës 16.08.2023 të drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Konkurrencës; Plotësimin e ankesës me numër të protokollit 1099/2023 të datës 23.08.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshill; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 24.08.2023 dhe 30.08.2023 nga Këshilli për Autoritetin e Konkurrencës, Konkursin me numër reference RN00011457 të datës 14.04.2023 për grupin e pozitave Specialist i Ekonomisë; Akt emërimin me numër 433/18-04/8 të datës 07.12.20218 të nëpunësit Aktin e emërimit me numër 279/19-06/B të datës 01.10.2019 të nëpunëses I. Zariqi; Aktin e emërimit me numër të protokollit 430/18-04/B të datës 07.12.2018 të ankuesit Aktin e emërimit me numër 106/13 të datës 27.08.2013 të Vendimin me numër 389/22-06/0 të datës 20.12.2022 të U.D Drejtorit të Përgjithshëm i Sekretariatit të Autoritetit të

Konkurrencës lidhur me emërimin e anëtarit të Komisionit të pranimit në cilësinë e ekspertit të jashtëm; Vendimin me numër të protokollit 173/23-06/B teëdatës 24.04.2023 të U.D Drejtori i Përgjithshëm për formimin e komisionit të pranimit; Listën e kandidatëve në pritje (pa datë dhe

numër); Listën e ngushtë të datës 26.05.2023 të kandidatëve që i plotësojnë kushtet për aplikim; Vendimin me numër protokollit 365/23-06/D të datës 09.08.2023 të U.D Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Konkurrencës; Vendimin me numër 383/23-06/B të datës 21.08.2023 të U.D Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Konkurrencës; Vendimin me numër 295/23-07/H të datës 27.06.2023 të Kryesueses së Komisionit të Pranimit në Autoritetin e Konkurrencës; Vendimin me numër 326/23-12/D të datës 18.07.2023 të Kryesueses se Komisionit të Pranimit në Autoritetin e Konkurrencës; Aplikacionin e datës 11.05.2023 të ankueses Kopje e ID-së;; Diplomën me Nr. 6482 të datës 30.09.2019 me të cilën dëshmohet se kandidatja ka përfunduar studimet në Universitetin e Prishtinës Fakulteti Juridik dhe mori titullin Jurist i Diplomuar; Vërtetimin me numër 08/424 të datës 11.05.2023; Letër referencën e datës 19.09.2018 të lëshuar nga Koordinatorja për Oden e Afarizmit të Kosovës; Vërtetimin me numër 475/18 të datës 02.05.2018 të lëshuar nga Administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Referencën e datës 31.07.2018; Referencën (pa datë dhe numër) të lëshuar nga drejtori lidhur me përvojën punës praktike në Interlex Associates; Vërtetimin e datës 25.04.2023 të lëshuar nga znj lidhur me përvojën e punës së kandidatës në kompaninë Kosovo Legal Services; Vërtetimin nën shenjën Ve.NR.78/2021 të datës 18.01.2021 të lëshuar nga Drejtori Ekzekutiv i Odes Avokatëve të Kosovës; Vërtetimin e datës 01.08.2021, të lëshuar nga Drejtori Gjeneral i Interlex Associates; Certifikatën e lëshuar në muajin mars 2022 lidhur me trajnimin "*Ligji dhe politika e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore*"; Certifikatën me numër 510/2023 lidhur me përfundimin me sukses të kursit të gjuhës angleze në nivelin Pre-Intermediate-B1; Certifikatën e datës 09.08.2021 lidhur me përfundimin e testit A1 në kursin e gjuhës gjermane ;Certifikatën e datës 14.05.2020 lidhur me përfundimin me sukses të kursit online " The right of Access to public documents Accountability and Transparency of Justice Institution in Kosovo; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Aktivizimin e Rinisë Do-okracia" Mirënjohjen (pa datë dhe numër) të lëshuar nga Këshilli i nxënësve të Prishtinës; Certifikatën e datës 18.06.2012 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Certifikatën e datës 28.06.2014 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Certifikatën e datës 20.06.2013 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Certifikatën e datës 16.06.2011 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Certifikatën e datës 28.06.2014 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Shkresën (pa datë dhe numër) të lëshuar nga BQK-ja, me të cilën e ka përfunduar praktiken studimore prej datës 01.07.2019 deri me 28 gusht 2019 në Divizionin e ankesave të shfrytëzuesve Financiar dhe Departamentin e Statistikave; Certifikatën lidhur me përfundimin e praktikës në KDI ne qershor-2019; Certifikatën e datës 31.08.2017 të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave e cila me sukses ka përfunduar praktikën në Departamentin Ligjor bazuar në memorandumun e Mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Financave dhe Universitetit të Prishtinës "*Hasan Prishtina*" të datës 19.01.2016; Certifikatën e datës 03.12.2018 lidhur me përfundimin praktikës në FINCA; Aplikacionin e datës 11.05.2023 të ankueses Kopje e ID-së; Certifikatën e datës 09.05.2023 mbi dënimet Penale; Diplomën Nr.6821 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti Ekonomik me të cilën mori titullin Bachelor për Menaxhimet dhe Informatikë; Vërtetimin me numër LRP.nr.4435/2021 lidhur me noterizimit të diplomës; Diplomën me numër 1587, të datës 11.12.2018 të Universitetit të Prishtinës, me të cilën mori titullin Master i Shkencave Ekonomike në Menaxhment dhe Informatike; Vërtetimin nën shenjen LRP.nr.4434/2021 lidhur me noterizimin e diplomës; Vërtetimin me numër 05.04.2023 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Certifikatën e datës 27.04.2021 lidhur me lidhur me pjesëmarrjen ne trajnimin "*Suksesi në Shitje*"; Certifikatën lidhur me përfundimin me sukses të trajnimit "*Inclusive Leadership and Company Sustainability*"; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në Modulën e Trajnimeve me temën "*PR dhe Marketingu Digjital*" të zhvilluar me datën

10.11.2022; Certifikatën (pa datë dhe numër) me anë të cilës dëshmohet se kandidatja ka marr pjesë në modulën e trajnimeve me temën "strategjitë e Marketingut dhe Shitjes" të zhvilluar me datë 03.11.2022; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në modulën e trajnimit me temë " Menaxhimi i Burimeve Njerëzore" të zhvilluara me datën 04,06 dhe 12 Tetor 2022; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen e modulit në trajnimin me temën "Leadershipi dhe Puna Ekipore" të zhvilluara me datën 18 dhe 20 Tetor 2022; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në Modulën e Trajnimeve me temën " Menaxhimi i Kohës dhe Stresit" të zhvilluar me date 26.10.2022; Certifikatën e datën 23.10.2021 lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin "Suksesi është qëllimi yt"; Certifikatën e datës 27.05.202 me anë të cilës dëshmohet se kandidatja ka marr pjesë aktive dhe në mënyre të suksesshme ka përfunduar trajnimin në programin " Informatikë për menaxhimin e afarizmit të ndërmarrjeve"; Certifikatën e datës 30.06.2012 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Certifikatën e datës 13.06.2016 lidhur me përfundimin me sukses të gjitha provimeve të parapara me rregulloren e brendshme të AFAS-it; Certifikatën e datës 29.07.2016 lidhur me përfundimin e punës praktike në Ministrinë e Financave të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm; Certifikatën e notave të datës 10.05.2023 të lëshuar nga universiteti " Haxhi Zeka" në Pejë; Diplomën me numër D-40/2016 të lëshuar nga Kolegji Evropian Juridika; Aplikacionin e kandidatit Kopje e ID-së; Certifikatën e datës 20.01.2023 të lidhur me përfundimin me sukses të punës praktike në kontabilitet; Pasqyrën e llogarisë Trustin për periudhën kohore 01.01.2021 deri me datën 31.12.2021; Pasqyrën e llogarisë trustit për periudhën kohore 01.01.2021 deri me datën 31.12.2021; Vërtetimin e punësimit të datës 26.03.2021; Kontratën e punës të datës të lidhur mes Titaniku SHPK me kandidaten Vërtetimin për punësim të datës 24.03.2021 të lëshuar nga punëdhënësi Titaniku SHPK; Letër rekomandimin e datës 29.03.2021 të lidhur me përvojën e punës në Glam Radio shpk; Diplomën me numër 305/17 të datës 08.04.2017 me të cilën kandidatja ka marr titullin master në programin Marketing dhe Biznes në Menaxhment; Diplomën me numër 1448/14 të datës 24.10.2014 me të cilën kandidatja mori titullin Bachaelor në Marketing dhe Biznes; Dokumentin e identifikimit; Aplikacionin e kandidatës Njoftimin përmes emailit të datës 21.07.2023 të Njesis së Burimeve Njerëzore drejtuar Emalin e datës 10.07.2023 të Q. Ibrahimimi drejtuar Emalin e datës 08.02.2023 të Njesisë se Burimeve Njerëzore drejtuar I. Zariqi; Pasqyrën e llogaris Trusti për periudhën kohore 03.03.2017 deri me datën 08.05.2023; CV e kandidatit Certifikatën e punës të datës 11.05.2023; Shkresën e datës 30.05.2022; Konfirmimin e punësimit të datës 22.04.2020; Letër referencën e datës 10.02.2020 lidhur me përvojën e punës ne "Prestigje"; Letër rekomandimin të lëshuar nga Drejtori i Drejtorisë se Urbanizmit në Komunën e Prishtinës Letër rekomandimin e datës 23.10.2018 të lëshuar nga Drejtori i Drejtorisë se Urbanizmit në Komunën e Prishtinës lidhur me përvojën e punës së kandidatit; Certifikatën e datës 01.04.2013 të lëshuar nga drejtori i ministrisë se Integritimeve Evropiane; Certifikatën e datës 11.05.2023; Aplikacionin e datës 12.05.2023 e kandidatës Dokumentin e identifikimit; Ankesën e datës 02.08.2023; Diplomën me numër 1013/17 të datës 28.07.2017; Vërtetimin e datës 12.05.2023 te lëshuar nga Universiteti "Haxhi Zeka" Pejë; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit " Foundation Training Programme on Competetion And State and Policy For Interns" ne Mars-2022; Certifikatën me numër 509/023 lidhur me përfundimin e kursit Britanica në nivelin B-1; Letër referencën e datës 21.08.2015 të lëshuar nga Grupi i Studimeve Juridikë dhe Politike; Vërtetimin e datës 25.04.2023; Vërtetimin e datës 25.04.2023 të lëshuar nga Drejtoresha e kompanisë LLC Legal Servis Kosova; Certifikatën e datës 09.02.2023 mbi demin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Aplikacionin e datës 10.05.2023 të kandidatit Dokumentin e identifikimit; Diplomën me numër 4764 të datës 16.06.2017 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti

Juridik me të cilën mori titullin Jurist i diplomuar ne Bachelor; Ankesën e datës 02.08.2023; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit programi për lidshp të mbajtur me 22.07.2016; Referencën e datës 22.03.2023 të lëshuar nga Kryeinspektori i inspektoratit të Tregut lidhur me angazhimin si praktikant profesional; Marrëveshjen me numër 03/31 të datës 04.01.2019 të lëshuar nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës lidhur me përvojën e të datës punës; Marrëveshjen me numër protokollit 5674 të datës 02.07.2019 për angazhimin në masë aktive të tregut të Punës-Praktike të lëshuar nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës; Kontratën për punë praktike të datës 01.09.2022 të lëshuar nga Drejtori i kompanisë Albi Comerc SH.P.K; Certifikatën e datës 23.12.2021 lidhur me përfundimin e kursit hyrjen e sigurimit të kibernetikës; Referencën e datës 28.02.2023 lidhur me punën praktike të përfunduar në kompaninë "Albi Comerc" Letër referencën e datës 22.03.2023 të lëshuar nga Kryeinspektori i Tregut në Ministrinë e Industisë Ndërmarrësis dhe Tregtisë; Aplikacionin të datës 09.05.2023 të kandidatit dokumentin e identifikimit; Ankesën e datës 02.08.2023; Certifikatën e datës 17.12.2007 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti Juridik; Diplomën e datës 24.01.2013 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti Juridik me të cilën vërtetohet se kandidati ka përfunduar studimet master në Banka Evropiane Investime; Certifikatën e lëshuar lidhur me përfundimin me sukses të kursit "Cisco Entrepreneur Institute Starting a Business V2.1" të lëshuar nga Menaxherja e Burimeve Njerëzore -MAP Certifikatën me numër 410/2016 të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Vërtetimin e datës 17.12.2013 lidhur me përfundimin e punës praktike në zyrën e Avokatit Letër rekomandimin e datës 10.11.2017 të lëshuar nga Menaxherja e Projekteve nga Fondacionin për Edukim dhe Zhvillim; Kontratën e Punës të datës 05.01.202, të lëshuar nga kompania "Migros Group"; Vërtetimin e datës 27.07.2018, të lëshuar nga kompania Migros Group sh.p.k; Certifikatën mbi dënimin penal të datës 17.04.2023; Aplikacionin e kandidatit kopje e ID-së, Diplomën universitare të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Ekonomik me të cilën kandidati mbrojt me sukses temën e studimeve të Masterit; Certifikatën nën shenjen ABC-086 (pa datë) e lëshuar nga Kryetarja e Bordit të Shoqatës së Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës; Referencën e datës 30.09.2018 të lëshuar nga kompania "King Sigumi"; Vendimin me numër 11-03 të datës 04.04.2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në Komunën e Obiliqit; Diplomën universitare të datës 05.10.2017 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Ekonomik me të cilën kandidati mori titullin Bachelor për Banka Financa, dhe Kontabilitet; Letër Rekomandimin e datës 30.05.2021 me të cilën dëshmohet përvoja e punës së kandidatës në "Online ShPK; Vendimin me numër 04/19 të datës 03.08.2020; Vendimin me numër protokollit 1330 të datës 08.09.2020 për emërimin e komisionit të Auditimit; Vendimin e datës 19.07.2021 lidhur me emërimin e kandidatës në pozitën e punës " Kryeshf Eksekutiv" në Kastrioti SH.A; Certifikatën mbi dënimin Penal të datës 01.02.2023 të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Pasqyrën e Llogarisë Trusti për periudhën kohore 16.12.2014 deri me 07.02.2023; Ankesën me numër protokollit 5729/2023 të datës 23.08.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për qasje në dokumente të datës 15.08.2023; Plotësimin e ankesës me numër protokollit 1098/2023 të datës 23.08.2023; Aplikacionin e datës 11.05.2023 të kandidatës Dokumentin e identifikimit; Diplomën me numër 6785 të datës 22.01.2020 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti Juridik me të cilën kandidatja mori titullin Jurist i Diplomuar; Certifikatën lidhur me përfundimin me sukses të trajnimit "Konkurrenca dhe ndihma e shtetit sipas ligjit dhe rregullave" (pa datë dhe numër); Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Kompania e Serviseve Legale në Kosovë"; Dëshminë me numër protokollit 5843 e punës të datës 17.01.2023 të lëshuar nga Zyrtarja e Burimeve

Njerëzore në "Ballkan Investigative Reporting Netëork"; Certifikatën e datës 08.01.2021 lidhur me përfundimin me sukses të kursit online "Kursi Fillestar" Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Humanitarin Laë Center Kosovo" të mbajtur nga 23-27.10.2017; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit " Të drejtat Njerëzore" të mbajtur me datë 15.10.2016 deri me 17.10.2016; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit " Mendimi kritik dhe shkrimi" të mbajtur me datë 29.07.2016; Certifikatën e datës 30.06.2014 lidhur me përfundimin kursit të gjuhës angleze në OXFORD; Kontratën pa(datë dhe numër) lidhur për praktikën në Kompaninë e Shërbimeve Legale në Kosove; vërtetimin me numër 07/062 të datës 10.05.2023 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës " Hasan Prishtina" Fakulteti Juridik; Vërtetimin me numër 680/2021 të datës 09.06.2021 të lëshuar nga u.d. Drejtori "Ekzekutiv i Odes së Avokateve të Kosovës; Emalin e datës 12.10.2023 të drejtuar KPMSHCK-së; Emalin e datës 12.10.2023 të KPMSHCK-së drejtuar Ankesën për procedurën e rekrutimit të datës 02.008.2023; Ankesën e datës 02.08.2023 të parashtruar nga Ankesën e datës 02.08.2023 të parashtruar nga Ankesën pa datë dhe numër; Kërkesën e datës 10.08.2023 të drejtuar u.d drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Konkurrencës;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat e marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankueseve është e bazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Autoriteti i Konkurrencës, me datë 14.04.2023, ka publikuar në sistem qendror elektronik (SIMBNJ), Konkursin për pranimit, me numër të referencës RN00011457, për emrin e grupit " *Specialistë të Ekonomisë* ", për vendin e punës *Inspektor Hetues i Konkurrencës*", klasa "Profesional 1", pesë (5) vende, e në të cilin konkurs kishin aplikuar edhe ankueset, ku të njëjtat janë përfshirë në të gjitha fazat tjera pasuese të vlerësimit.

Më tej, nga provat materiale të kësaj çështje rezulton, se Komisioni i Pranimit me datë 31.07.2023 ka përgatitur Listën Përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve, sipas së cilës renditje ankuesja ka arritur 86.4 pikë duke u renditur si kandidata e dytë me më shumë pikë, ndërsa, ankuesja është vlerësuar më gjithsej 85.2 pikë, duke u renditur si kandidata e katër me më shumë pikë.

Të pakënaqur me rezultatin përfundimtar të vlerësimit të datës 31.07.2023, kandidatet:

që të gjithë më datë 02.08.2023 parshtrajnë ankesë pranë organit të punësimit, ndërsa u.d Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës më Vendimin Nr.76/23 të datës 09.08.2023, ka anuluar procedurën e vlerësimit të jetë shkrimit dhe intervistës më gojë, lidhur me konkursin më numër të referencës RN00011457, duke autorizuar Njësinë e Personelit që të organizoj përsëritjen e vlerësimit të jetëshkrimit dhe intervistës më gojë, mbi bazën se ka pasur shumë ankesa lidhur me vlerësimin e jetëshkrimit dhe intervistës me gojë. Më tej, Komisioni i Pranimit më datë 10.08.2023, drejton njoftimin më shkrim tek Njësia e Burimeve Njerzore me sqarimin se procedura e pranimit me numër të referencës RN00011457 është zhvilluar në pajtim më Rregulloren Nr.16/2020. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, ende pa përfunduar procesi i rivlerësimit sipas Vendimit Nr.76/23 të datës 09.08.2023, nxjerrë Vendimin Nr.80/2023 të datës 21.08.2023, duke anuluar në tërësi Konkursin për pranimit, me numër të referencës RN00011457 ,si dhe ka shfuqizuar Vendimin Nr.76/23 të datës 09.08.2023, tani me arsyetimin se ky proces është përcjell me parregullsi dhe vonesa të cilat kanë ndikuar në vlerësimin e drejtë të kandidatëve.

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore në fuqi referuar procedurës dhe kushteve të pranimit të nëpunësve civilë, përkatësisht:

- Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë, ku me nenin 34 përcaktohet: 1. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, pranimi në Shërbimin Civil bëhet në kategorinë profesionale në grupin e administrimit të përgjithshëm dhe në secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 2. Pranimi në kategorinë profesionale bëhet nëpërmjet një konkurrimit të hapur dhe publik. Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike dhe sipas nevojave dhe së paku një herë në vit, për grupin e administrimit të përgjithshëm dhe për secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 3. Konkurrimi organizohet nga DMZP për institucionet e administratës shtetërore dhe nga Njësia e Burimeve Njerëzore për çdo institucion tjetër (në tekstin në vijim: njësia përgjegjëse). 4. Njoftimi për hapjen e procedurës të konkurrimit shpallet në një afat jo më të shkurtër se 21 ditë, nga data e përcaktuar për paraqitjen e aplikimit, nga njësia përgjegjëse, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me mjete të tjera të përshtatshme. Afati për pranimin e aplikacioneve nuk mund të jetë më i shkurtër se 8 dite dhe jo më i gjatë se 15 ditë kalendarike. 5. Shpallja e konkursit, sipas paragrafit 4 të këtij neni, përfshin përkrahimin e përgjithshëm të punës për grupin përkatës, pozitën e punës të lira në grupin përkatës, kriteret që duhet t'i plotësojnë kandidatët, afatin për aplikim, të dhënat e hollësishme për zhvillimin e procesit të përzgjedhjes dhe dokumentacionin që duhet paraqitur për aplikim. 6. Konkurrimi zhvillohet në dy faza: 6.1. verifikimi paraprak, nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; 6.2. vlerësimi i njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 7. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia e përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Komisioni i pranimit (në vijim: Komisioni i pranimit), i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë për të cilin zhvillohet konkurrimi....

-Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku me nenin 14 është përcaktuar se: Fazat e konkurrimit 1. Konkurrimi për pranimin në bimin civil, përfshin dy faza: 1.1. Verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. Vlerësimi i kandidatëve. Neni 25 përcakton se: 1. Komisioni i Pranimit, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurimit me fitues që përfshin edhe një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njesisë Përgjegjëse brenda ditës pasuese të punës nga miratimi i saj. 2. Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues. Njësia Përgjegjëse publikon listën e kandidatëve fitues në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje. 3. Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar se paku me shtatëdhjetë 70 pikë, Komisioni i Pranimit, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurimit pa fitues. Njësia Përgjegjëse publikon njoftimin për përfundimin e procedurës të konkurimit pa fitues, në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje. 4. Në çdo rast, Njësia Përgjegjëse njofton individualisht çdo kandidat pjesëmarrës në fazën e vlerësimit. Njoftimi përfshin renditjen e kandidatit dhe rezultatin e detajuar të vlerësimit të kandidatit në çdo hap të vlerësimit. 5. Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual. 6. Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj. Nëse rishqyrtimi sjell ndryshimin e renditjes zbatohet përshtatshëmrisht ky nen i kësaj Rregulloreje....."

Në kuptim të kuadrit ligjor si lartë, Kolegji i Këshillit ka analizuar provat materiale të kësaj çështje si dhe aktin administrativ të kundërshtuar me ankesa përkatësisht Vendimin Nr.80/23 të datës 21.08.2023, të U.d Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Konkurrencës për anulimin e Konkursit me numër të referencës RN00011457, për pozitën e punës Inspektor Hetues i Konkurrencës, dhe si rrjedhojë konstatoi se i njëjti është nxjerrë nga personi jo kompetent dhe në kundërshtim të plotë me dispozitat materiale. Rrjedhimisht, U.d Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës me nxjerrjen e Vendimit Nr.76/23 të datës 09.08.2023 dhe Vendimit Nr.80/23 të

datës 21.08.2023, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 25 paragrafit 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimit dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, më të cilat është përcaktuar se: *Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj*” sepse, pas parashtrimit të ankesave të kandidatëve kundër vlerësimit përfundimtar të datës 31.07.2023, Komisioni i Pranimit ka qenë i autorizuar dhe përgjegjës që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesat e parashtruara, pra, mbi këtë bazë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrues nuk ka tanger ligjor për vlerësimin e ligjshmërisë së procedurave të rekrutimit, përfshirë anulimin apo lënien në fuqi të konkurseve të shpalluara. Andaj, nisur nga këto fakte, Kolegji në vështrim të dispozitave të nenit 52 të Ligjit të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton se një akt administrativ i nxjerrë nga organi jokompetent dhe me shkelje ligjore konsiderohet akt i paligjshëm dhe si i tillë nuk prodhon asnjë pasojë juridike.

Siç u përcaktua më lartë, rrjedhimisht duke qenë se Vendimi Nr.80/23 i datës 21.08.2023, i Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Konkurrencës për anulimin e Konkursit me numër të referencës RN00011457, për pozitën e punës *Inspektor Hetues i Konkurrencës*, është nxjerrë nga organi jokompetent dhe në kundërshtim më dispozitat materiale, Kolegji i Këshillit vlerëson se pretendimet ankimore të ankueseve janë të drejta dhe të bazuara, kështu që, duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi që të anulohet Njoftimi i datës 21.08.2023, i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Konkurrencës dhe Vendimi Nr.80/23, i datës 21.08.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Konkurrencës, duke lënë në fuqi renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 31.07.2023, si dhe duke obliguar Komisionin e Pranimit që të shqyrtoj ankesat e datës 02.08.2023 të kandidatëve:

dhe të nxjerrë akt administrativ në pajtim

me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.1099/2023

Ardita Përcuku Shyti

Ardita Përcuku Shyti
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Ardita Haxhnikaj DEMI
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueseve;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Konkurrencës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.